

VENDIM
Nr. 43, datë 13.5.2014

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.5.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 147, datë 24.12.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012 do t’i shtrijë efektet deri në datën 31.12.2014.”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti